



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor

**Sociologji me profile: “Sociologji Politike”, “Antropologji Sociale”,
“Administratë Publike”, “Marrëdhënie Publike” dhe “Gazetari”**

Ofruar nga

Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Merita Xhumari
2. Dr. Dorianë Pano

Shtator/2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në Sociologji me profile: “Sociologji Politike”, “Antropologji Sociale”, “Administratë Publike”, “Marrëdhënie Publike” dhe “Gazetari” ofruar nga Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”



Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Sociologji” me profile: “Sociologji Politike”, “Antropologji Sociale”, “Administratë Publike”, “Marrëdhënie Publike”, “Gazetari” Sociologji”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 534 datë 07.09.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike/6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	24 PAE/1 PAK v.a. 2019-2020 12 PAE/0 PAK v.a. 2020-2021 12 PAE/0 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	3 studentë v.a. 2019-2020 0 studentë v.a. 2020-2021 0 studentë v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	Për shkak të faktit që në këtë program studimi nuk ka studentë të regjistruar për 2 vite akademike të njëpasnjëshme, IAL ka kërkuar ta mbyllë këtë program studimi.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Sociologji”, me profile: "Sociologji Politike", "Antropologji Sociale", "Administratë Publike", "Marrëdhënie Publike", dhe Gazetari, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, të Universitetit Europian të Tiranës, sipas përcaktimeve të Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 526, datë 04.09.2018, “Për riorganizimin e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në Universitetin Europian të Tiranës”. Ky program është riorganizim i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Sociologji-Antropologji Sociale” me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 534, datë 07.09.2018. Ky program studimi është hapur për herë të parë në vitin akademik 2011–2012 sipas Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 408, datë 22.08.2011 dhe është akredituar në përputhje me parashikimet ligjore me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 306, datë 26.08.2015 (bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit Nr. 38, datë 05.05.2015). Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, në formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Sociologji”, me profile:

- a. Marrëdhënie Publike.
- b. Antropologji Sociale.
- c. Sociologji Politike.
- d. Administratë Publike.
- e. Gazetari.

Programi i studimit bachelor në “Sociologji” në vitin akademik 2021-2022 nuk ka të rregjistruar ndonjë student. Numri total i studentëve që ndjekin këtë program studimi është 3.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm


Bazuar në procedurat standarde, ASCAL caktoi si ekspertë për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Bachelor në "Sociologji", me profile: "Sociologji Politike", "Antropologji Sociale", "Administratë Publike", "Marrëdhënie Publike", dhe Gazetari ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës (UET), Prof. Asoc.Dr. Merita XHUMARI dhe Dr. Dorianë PANO, të mbështetur nga koordinatori i ASCAL, MSc. Muhamed PREZJA.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka nisur në muajin shkurt 2022, me dorëzimin nga ana e Universitetit "Europian i Tiranës (UET) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL. Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me UET, në datën 5 Prill 2022, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Koordinatorin e programit të studimit, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Sektorit të Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me përfaqësues të Njësive të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, me studentët e programit të studimit dhe me përfaqësues të Sektorit të Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Takimi i drejtpërdrejtë me stafet akademike dhe studentët e programit ishte i rëndësishëm për të konfirmuar një pjesë të mirë të standardeve të verifikuara nga dokumentacioni. Vëzhgim i mjediseve të reja të UET si auditorët, laboratorët, biblioteka dhe shërbimet për studentët krijojnë bindjen se mesimi zhvillohet sipas standardeve bashkëkohore.

Institucioni i vuri në dispozicion GVJ dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e këtij programi studimi, i cili ishte shqyrtuar paraprakisht nga ana e ASCAL dhe GVJ. GVJ gjatë vizites në institucion kërkoj dokumentacion/informacion shtesë në lidhje me ngarkesën e stafit akademik të brendshëm, mënyrën e vlerësimit të performancës së tij dhe të dhënat për studentët. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.

Pasi GVJ u njoh me komentet e institucionit rreth përmbajtjes së Draft Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dërguar pranë "Universitetit Europian të Tiranës", vendosi të qëndroj gjetjeve të saj dhe të mos marrë në konsideratë ato duke mos bërë ndryshime në përmbajtje.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Sociologji”, me profile: “Marrëdhënie Publike”, “Antropologji Sociale”, “Sociologji Politike” dhe “Administratë Publike” dhe “Gazetari”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE



Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Program i studimit Bachelor në Sociologji duke pasur si synim plotësimin e një kontigjenti specialistësh në fushën e sociologjisë, e duke diversifikuar ofertën në pesë profile, jo vetëm nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por synon një profesion që mungon. (Plani Strategjik 2015-2020. Referenca 3).			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit në fushën e Sociologjisë ka të bëjë me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, veçanërisht Antropologjia, Sociologjia e Kultures, etj. Programi duke nxjerrë Sociologe profesionale mbështet njëkohësisht dhe zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë. (Statuti UET, Referenca 2 dhe Syllabuset e lendeve-Referenca 19).			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Sociologji” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e UET për qytetarë aktivë për një shoqëri demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. (Strategjia e Kerkimit Shkencor e UET 2017-2020 dhe 2021-2025. Reference 3).			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Nga takimet me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi si dhe me studentë, GVJ konstaton se qëllimi i Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është të krijojë premisa të mira për një arsim cilësor duke e arritur këtë nëpërmjet hartimit dhe jetësimit të programeve të studimit, sikurse është dhe program i studimit Bachelor në “Sociologji”, në shërbim të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar, me fokus primar përsosmërinë dhe bërjen e tij sa më kompetitiv në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Misioni i program i studimit Bachelor Sociologji me profile është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të UET, me standardet ndërkombëtare, si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë në vend dhe më gjerë, duke e orientuar drejt qëllimeve kryesore si kërkimi shkencor dhe mësimdhënia.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	institucioni në fjalë ka objektiva të qarta të mbështetura në strategjinë e zhvillimit të Universitetit, UET” si institucion dhe strategjinë e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara Institucioni ka një plan strategjik zhvillimi për periudhën 2021-2025, pjesë e të cilit janë dhe programet e studimit, sikurse është dhe program i studimit Bachelor në “Sociologji”. (Plani Strategjik. Referencë 3 dhe 3.3)			
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Në Statutin dhe Rregulloren UET përcaktohet se për programet e studimit në këtë institucion janë të përcaktuara drejtimit prioritar akademike të UET (Statuti i UET. Referencë 2 dhe Rregullore e UET. Referenca 5). Gjithashtu në prioritetet strategjike përcaktohet një agazhimi pozitiv në një gamë të gjerë tematikash, duke përfshirë planifikimin dhe hartimin e strategjive zhvillimore, me shtrirje dhe ndikim në komunitet.			
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Misioni i Departamentit që ofron kete program studimi është i qartë. Fushat dhe ekspertiza që programi bachelor në “Sociologji” ofron përputhen me fushat akademike dhe drejtimit që institucioni ka. Siç përcaktohet në Rregullore, Programi i studimeve Bachelor në Sociologji” është program studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale tre vite akademike, i cili merr përsipër të ofrojë drejtimit akademike të institucionit dhe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	Referuar Rregullores së programit të studimit Bachelor në “Sociologji” si dhe takimeve me Përgjegjësin e Departamentit dhe anëtarë të tjerë (Takime në institucion), GVJ konstaton se janë përcaktuar qartë objektivat e formimit të cilat konsistojnë në sa vijon (Rregullore e programit të studimit BA Sociologji. Referencë 7, Pika 3, 3.1.2.3 fq.2,3) Programi i studimit Bachelor, synon ta pajisë studentin me: a. Njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit; b. Aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; c. Formim qytetar të përgjithshëm; d. Aftësi bazë për punë kërkimore; e. Aftësi të përgjithshme praktike, aplikative; f. Aftësim për promovim personal;
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që	GVJ konstaton se pavarësisht se UET ka ngritur disa struktura mbështetëse për të realizuar një analizë të tregut të punës, kjo si

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>nevojë nga momenti i riorganizimit të këtij programi, duke marrë parasysh si kërkesat e tregut të punës, ashtu dhe interesat e vetë studentëve, nisur nga numri i ulët i të rregjistruarëve, ku në vitin akademik 2021-2022 nuk ka studentë të rregjistruar, rezultojnë se ky studim është kryer duke reflektuar mbi kërkesat nga punëdhënësit si dhe nga të punësuar në sektorë të ndryshëm, por jo drejt përdrejt në këtë fushë apo disiplinë. Bordi i Tregut të Punës i krijuar nga UET mund të kishte një rol më proaktiv për orientimin në punësimin e vetëm 6 studentëve të diplomuar në këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formuese garantojnë përfundimin e dijeve dhe i përgjigjen në mos nevojave të tregut të punës, kriterëve që punëdhënësit kërkojnë për vende pune specifike. Referuar syllabuseve të lëndëve (Referencë 19), takimeve me pedagogë të angazhuar në këtë program studimi, takimeve me studentë (Takime në institucion) si dhe statistikave të punësimit, GVJ është i mendimit se objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave. Pavarësisht kësaj, mund të themi që edhe nga biseda me anëtarët e GVB dhe stafin akademik të departamentit, administrata publike perceptohet si një treg pune relativisht i madh dhe jo shumë fleksibel për këtë fushë studimi, ndërsa pjesa tjetër e tregut funksionon në mënyrë informale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Sipas RVB, në programin e studimit "Sociologji" për vitin akademik 2019-2020, janë angazhuar 24 PAE, nga të cilët 4 me titullin Prof. Dr., 3 me titullin Profesor i Asociuar, 10 me gradën Doktor dhe 7 (shtatë) personel akademik me MSc dhe 1 PAK me gradën Dr. Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 12 PAE dhe 0 PAK dhe në Vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar po 12 PAE dhe 0 PAK (Referencë Ankes Tabela 6,7,8). Pedagogët kanë formim juridik, ekonomik dhe në lëmin e sociologjisë, shkencave politike, historisë etj. Programi arrin të ndërthurë këto kapacitete të cilat plotësohen dhe nga resurse të tjera jashtë Departamentit në nivel Fakulteti dhe Universiteti.</p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e studimit e Sociologjise nuk përputhet plotësisht me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit ndërkombëtar të programeve të studimit. Sociologjia klasifikohet ne 03 Shkencat Sociale, perputhet me emertimin e Departamentit qe e ofron, por jo me emertimin e Fakultetit te Shkencave Juridike, Politike, fusha te cilat kane qene bashke por tashme jane ndare ne dy klasifikime: Shkencat Juridike kane kaluar ne klasifikimin 04. Juridike dhe Biznesi sipas ISCED.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Njësia bazë e orienton dhe punën kërkimore shkencore në përputhje me programet që ofron. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara. Vërtetohet një përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike me fushën akademike e kërkimore të Departamentit përgjegjës për programin e studimit. (Të dhëna për numrin e programeve që ofron njësia përgjegjës Aneks Tabela 3, Reference 26)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plot përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Administrimi i programit të studimit Bachelor në “Sociologji” realizohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, mbështetur në Rregulloren e Programit të Studimit (Rregullore e Programit të Studimit Referencë 7), Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, si dhe gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik nga fakultete të tjera dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë, bazohet në marrjen e përgjegjësive respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre (Takime në institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, ku lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare zhvillohet në kuadër Institucional. UET ka fituar disa projekte te BE per rritjen e cilesise se mesimdhënie (Marrëveshje bashkëpunimi. Referencë 34). Për zhvillimin e praktikave mësimore, UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme vendase. Gjithësesi, GVJ nuk gjen marrëveshje specifike në nivel departamenti për këtë program qe ndoshta do sherbente si nje nxitje per studentet e Sociologjise edhe per mundesi punesimi.</p>

Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Referuar RVB dhe takimeve në institucion rezulton se ka një raport analitik mbi përfitimet e marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve në funksion të realizimit të programeve të studimeve (Referencë 35).			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	Institucioni ka siguruar bashkëpunim me punëdhënësit për kryerjen e praktikave mësimore, e vendosur kjo përmes marrëveshjeve të realizura. Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar edhe nëpërmjet akteve të brendshme, ku përcaktohen detyrat dhe roli i aktorëve të përfshirë në këtë process. (Dokumenti B.1. dhe B.1.5 Mbi praktikat profesionale. Reference 32.1)			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Gjatë vizitës në Institucion dhe gjatë takimeve me aktorë të përfshirë në këtë process, na u referua se trajnimet kryesisht ofrohen nga disa struktura si Bordet e Tregut të Punës, Klubet studentore, UET Alumni, të cilat ofrohen jo vetëm për studentët e diplomuar, por edhe për studentët të cilët ende janë në proces studimi në UET. (Të dhënat për trajnimet profesionale. Reference 33 dhe Takime në institucion)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ky kriter respektohet plotësisht. Kursi është ndarë në lëndë dhe module të cilat kanë nga 4-6 kredite ECTS. Kjo ndarje ofron fleksibilitet në transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, ndërsa punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar janë të vlerësuara me 7 kredite. Totali i krediteve që studenti duhet të marrë për t'u diplomuar është 180 ECTS (Kurrikula e programit BA Sociologji. Reference 14)
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi Bachelor në "Sociologji" synon kualifikimin e studentëve me njohuri të përgjithshme, të vetëdijshëm për sfidat që i presin, si rrjedhojë, u jep mundësi që përveç formimit të tyre bazë në fushën e Sociologjisë, të mund të pajisen me njohuri shtesë në fusha të tjera, të lidhura me profesione të caktuara, ku ata mund të aplikojnë konceptet e Sociologjisë. Ata kanë nevojë jo vetëm për njohuri teorike dhe praktike, por duhet të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	jenë në gjendje të shprehin veten dhe të jenë ndërmjetës midis institucioneve dhe shoqërisë.			
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi synon të japë njohuri praktike dhe teorike mbi aspekte të përgjithshme e të veçanta të fushës së studimit. Një prej aspekteve që theksohet shumë është mundësimi i aplikimit në praktikë të koncepteve themelore; aftësi bazë për punë kërkimore; krahasimin midis modeleve të ndryshme teoriko- empirike etj. (Rregullore e programit të studimit BA Sociologji Referencë 7)			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit bachelor në “Sociologji” zhvillon dhe kultivon aftësitë e studentëve për mendim të pavarur kritik, nëpërmjet aplikimit të teorive dhe formave e metodologjive të studimit. (Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës. Reference 39)			
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit Bachelor në “Sociologji” ofrohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Rregulloren e Fakultetit dhe Rregulloren e Programit të Studimit. (Referencë 7)			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Referuar RVB dhe dokumentave mbështetëse, rezulton se plani mësimor bachelor në “Sociologji” është i ndarë sipas veprimtarive formuese nga A-E, (Referencë 14, 14.1) me një shpërndarje të barabartë kreditesh në semester si më poshtë: 35 ECTS studentit I ofrohen nga lëndët bazë; 96 ECTS nga lëndët karakterizuese; 24 ECTS nga lëndët ndërdisiplinore të profilit; 18 ECTS nga lëndët plotësuese; 7 ECTS nga detyrimet përmbyllëse, diplomimi student e shlyen ose me provim përfundimtar (shkrim), ose punim diplome në rastet kur studentët janë me mesatare 8.541. (Kurrikula e programit BA Sociologji, plani mësimor I programit I ndarë sipas veprimtarive formuese. Referencë 14, 14.1, 14.2)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit Bachelor në “Sociologji” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, pranë Fakultetit Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare i cili ka në përbërje të tij 3 Departamente (Statuti UET, Referencë 2. Aneks 1)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë	1)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Moza
Elroy


përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	1. Departamenti i Shkencave Juridike, 2. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, 3. Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor.										
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Institucioni, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar: Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Njesisë Kryesore, Rregulloren e Njesisë Bazë.										
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Në strukturën e Departamentit operojnë Përgjegjës i grupit mësimor, i cili koordinon dhe ndjek ecurinë dhe zhvillimin e programit për grup lëndët e caktuara dhe raporton tek përgjegjësi I departamentit. Mbi bazën e tyre është ngritur Struktura Akademike e Fakultetit.										
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara në vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga 9 PAE, nga të cilët 6 kanë titullin Prof. Dr., 2 Prof. As., dhe 1 Msc. Gjithashtu edhe 1 PAK me gradën Dr. (Tab.7 tek Tabelat përmbledhëse).										
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli</th> <th>Përmbushet përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli	Përmbushet përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					X
Niveli	Përmbushet përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht							
				X							

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, që ofron programin bachelor në “Sociologji”, disponon të gjitha informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij programi studimi, në përputhje me statutin dhe rregulloren e Universitetit, rregulloren e fakultetit dhe të departamentit. Cdo anëtar i stafit akademik dhe student informoheshin nëpërmjet platformës LMS. (Manulai i përdorimit të sistemit UMIS Referencë 46 dhe Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS). Reference 46.1)
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Sociologji” është i organizuar në: - 5 lëndë bazë (Kategoria A – 35 ECTS – 20%), - 13 lëndë karakterizuese (Kategoria B – 96 ECTS – 53%), - 4 lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese dhe grup-lëndë me zgjedhje (njëra me zgjedhje midis 2 mundësive – Kategoria C –
Kriteri 3. Programet e studimit	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>24 ECTS – 13%), - 4 lëndë plotësuese (Praktika profesionale - Kategoria D – 18 ECTS – 10%) - 1 detyrime përmbyllëse (Mbrojtja e diplomës - Kategoria E – 7 ECTS – 4%). Secili aktivitet është vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është 3 vjeçar, i organizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me 180 kredite (ECTS). Viti akademik i programit të studimit Bachelor në “Sociologji” me profile përmban 6 semestra të rregullt mësimor me kohëzgjatje 15 javë mësimore. (Plani mesimor I ndare sipas veprimtarive formuese BA Sociologji. Referencë 14.2, Tab 9)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në planin mësimor (Plani mesimor BA Sociologji. Referencë 14.1, Tab 10,13) të programit të studimit Bachelor në “Sociologji” me profile, si dhe në syllabuset e lëndëve (Syllabuset e lëndëve. Referencë 19) jepet ngarkesa e studentëve në auditor, por mungojnë orët jashtë auditorit për çdo aktivitet formues. Sugjerojmë që brenda syllabusit të çdo lënde, të përcaktohej frekuentimi/ndjekja e programit, (mungonin tek disa), përvec se në rregulloren e programit të studimit, mënyra dhe forma e vlerësimit të risilleshin brenda syllabusit të lëndëve.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Regullore e programit të studimit BA Sociologji. Referencë 7, pika 2, 9) [cit]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Për t’u pranuar në këtë program studimi kandidati/studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimet e detyrueshme të Maturës Shtetërore, të plotësojë kriterin e notës mesatare sipas legjislacionit në fuqi, dhe të zotërojë një diplomë të shkollës së mesme të përgjithshme me kohëzgjatje tre vjet, ose sipas sistemit të vjetër me kohëzgjatje katër vjet, ose dhe shkollë të mesme profesionale</i> - <i>Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund t’u njihen kredite të fituara në programe të tjera studimi në fusha të njëjta ose të përafërta, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren përkatëse të transferimeve në UET, por edhe njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara siç mund të jenë njohuri të informatikës, ose edhe të gjuhës së huaj, apo njohuri të veprimtarive formuese të nivelit të pas shkollës së mesme të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit të studimit.</i>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e detajuara të çdo lënde (Syllabuset e lëndëve. Referencë 19), bazuar në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në “Sociologji” me profile, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare, si dhe ngarkesën përkatëse brenda auditorit.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Sociologji” me profile parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, kjo edhe duke ecur me nevojat e tregut të punës, por programi ka vetëm 3 vite në zbatim (Takimi në institucion me përgjegjesin dhe staf akademik).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.4</p>	
<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënies dhe vazhimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Sociologji” me profile është hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program studimi, ofrohet me kohë të plotë, dhe i strukturuar me kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike, me nga 60 ECTS secili. Në të kombinohen lëndë teorike, lëndë me zgjedhje, praktika dhe punimi i diplomës.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese që ofrohen në këtë program studimi janë në përputhje me fushën e studimit dhe llojin e diplomës, gjë që mundëson studentët për punësim. Lëndët kanë një shpërndarje të barabartë në vite duke mundësuar dhe aftësimin praktik.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënies dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Për nga natyra programi është i balancuar dhe arrin objektivat formuese. Programi i studimit Bachelor në “Sociologji” me profile ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale. (Rregullore e programit të studimit. Referencë 7).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ është e mednimit se Struktura e programit të studimit Bachelor në “Sociologji”, në tërësi me lëndët në semestra, kredite dhe raporti teori apo praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe i ngjashëm me programet ndërkombëtare. (Dokumenti A.III. Mbi parimin e ndërtimit të programit të lëndës. Referencë 39)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese përmes trajtimeve teorike, praktike, seminareve apo aktivitete të tjera, lehtësojnë arritjen e objektivave mësimore, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin në fund të programit të studimit. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara ka arritur të ketë një program të ndërtuar sipas kërkesave të “Sistemit të Bolonjës” i cili krijon kushtet për të marrë pjesë në një nga objektivat e kësaj marrëveshje që është pikërisht Sistemi European i transferimit të Krediteve (European Credit Transfer System – ECTS), duke krijuar mundësinë që kreditet të transferohen nga universitetet e vendit në universitetet e tjera brenda dhe jashtë vendit. edhe pse nga konstatimi gjatë leximit të syllabuseve, gjetëm tituj të vjetër botimesh. Edhe pse nga ky program këto 3 vitet e fundit nuk ka pasur studentë që kanë përfituar nga mobilitet. (Reference 28)</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen në bashkëpunim dhe me njësi përgjegjëse, me qëllim azhurnimin e tyre në përputhje me dinamikën e zhvillimeve në vend, por edhe proceseve të globalizimit. Në bazë të rregullores dhe takimeve në institucion me staf akademik, syllabuset kalonin në një fazë rifreskimi sa i takon literaturës dhe përmbajtjes së temave. (Reference 17)</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programin i studimit Bachelor në “Sociologji” me profile është bazuar në modele programesh studimi ndërkombëtare në bashkëpunim të ngushtë me institucione të ndryshme publike dhe private në fushën e sociologjisë së aplikuar, marrëdhëniet shoqërore në raport me institucionet, duke garantuar përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në përputhje kërkesat e tregut të punës. (Plani strategjik për zhvillimin e programit. Reference 4, 17)</p>			
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nisur nga përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Sociologji” me profile rezulton se qëllimi i kurrikulës në këtë program studimi është t’u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional dhe shkencor. (Rregullore e programit të studimit. BA Sociologji. Referencë 7)</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Për përmirësimin e programeve të studimit dhe përshtatjen sa me te mirë në tregun e punës, departamenti ka hartuar “Analizën e tregut të punës”, e cila merr në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të UET, gjithësesi numri I ulët I studentëve të rregjistruar në këtë program studimi, është tregues se tashmë ky program do duhet të ketë një tjetër nënëndryje profilësh duke përjashtuar, psh marrëdhënie publike, administratë publike (Referencë 17).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.5


Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Në këtë program studimi departamenti është kujdesur që të angazhojë pedagogë me grada e tituj shkencorë si dhe profesionistë me eksperiencë dhe që janë në proces të përfundimit të studimeve doktorale, ku përfshin ekspertë ligjorë ekonomik e politik.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti dhe personeli akademik angazhohen në realizimin e ngarkesës mësimore sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Personeli i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik. Në zhvillimin e programit të studimit për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik efektiv PAE , nga të cilët 8 me grada dhe tituj (2 Prof. Dr.; 3 PhD.; 3 Dr.) dhe 4 asistentë lektorë MSc si dhe asnjë PAK. Po ashtu edhe për vitin 2021-2022 janë angazhuar 12 anëtarë të personelit akademik efektiv PAE , nga të cilët 8 me grada dhe tituj (2 Prof. Dr.; 3 PhD.; 3 Dr.) dhe 4 asistentë lektorë MSc si dhe asnjë PAK.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara zotëron një personel të kualifikuar dhe një strukturë të organizuar në mbështetje të aktivitetet mësimore dhe kërkimor dhe në përmbushje të objektivave të këtij programi studimi. (Personeli akademik. Referencë tabela 6,7,9)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi edhe me institucione që në të ardhmen mund të jenë punëdhënës të studentëve të diplomuar. (Memorandum bashkëpunimi me ZVA-Tirane, Referencë 34.5. Memorandum bashkëpunimi me FSHS, Referencë 34.13; Memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Shkondrës, Referencë 34.12 dhe Bashkinë Tiranë, Referencë 34.7)</p> <p>Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, me mbështetjen edhe të Zyrës së Karrierës, ka lidhur memorandume bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm, duke garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione dhe për të ftuar ekspertë të fushës. (Lista e subjekteve bashkëpunuese; Marrëveshje bashkëpunimi. Referencë 32; 34)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve dhe trajnimeve specifike laboratorike. Studentët përfitojnë nga mjediset e përshtatshme, si 4 laborator e informatikës, biblioteka dhe salla për veprimtari promovuese etj (Infrastruktura në funksion të programit të studimit. Referencë 42;42.1).Për qëllime kërkimore apo projekte studimore, studentët mund të përdorin infrastrukturën elektronike që institucioni disponon. Gjatë vizitës në Institucion, pamë disa salla ku zhvilloheshin leksionet ku të gjitha ishin të pajisura me mjete si PC, Projektore, foni dhe internet.</p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ nuk ka patur akses në një udhëzues specifik në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Megjithatë, në një sërë dokumentash si “Statuti i UET” (Statuti UET. Referencë 2), “Plani Strategjik UET 2021” (“Plani Strategjik UET 2021” Referencë 3.3), “etj. paraqiten disa prioritete të tilla si: Inovacioni dhe kreativiteti i burimeve njerëzore të qenurit proaktiv dhe kritik, etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Strukturat përgjegjëse, Zyra e Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, etj, zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me mekanizma të tillë si me “Formularin e vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik” (“Formulari i vetëvlerësimit të performancës të personelit akademik” Referencë 41), (Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu Referencë 30.8 G-III-4-1, & (Takime në institucion).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Personeli akademik vlerësohet nga studentët mbi bazën e plotësisht të dy formulareve akademik, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të tij ku analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit: (Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët Referencë 40. G-III-4-2) dhe (“Formular për ankesat e studentëve. Referencë 40.1. D-VI-3-3)
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Gjatë vizitës në UET, GVJ kuptoi që Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UET, së bashku me Departamentin, Dekanin dhe Drejtorin e IT, bëjnë publike për të gjithë stafin akademik në formë të personalizuar vlerësimin e dhënë nga studentët. Ky vlerësim tregon në përqindje vlerësimin për secilën pyetje të bërë. Në përfundim të procesit të vlerësimit Komisioni harton Raportin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, një kopje e të cilit

	depozitohet në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe tek Administratori. Raporti i i Vlerësimit të Performancës së personelit akademik përdoret si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit ndërmjet UET-it dhe personelit akademik të brendshëm e të jashtëm të tij, si në drejtim të kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punësimit, ashtu edhe të shpërblimit			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Institucioni merr në analizë gjithë problematikën që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor, Informacioni i përfuar nga pyetsori i studentëve, formulari i vetvlerësimit të personelit akademik, kontrolleve të ushtruara etj. janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.(Takime në institucion)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga analiza e dosjes së programit të studimit “Sociologji” me profile (Plani mësimor i programit të studimit BA-Sociologji, Referencë) si dhe nga takimet me përgjegjësin e departamentit, personelin akademik dhe studentët (Takime në Institucion) rezultojnë se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive për këtë program studimi janë leksionet, seminarët detyrat e kursit, praktika profesionale si dhe orët e hapura. përfshi përdorimin e teknologjisë së informacionit, me qëllim qoftë lehtësimin e mësimdhënies, qoftë përmirësimin e kompetencave të studentëve në përdorimin e teknologjisë.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Format e mësimdhënies gërshetojnë formimin klasik nëpërmjet veprimtarive në auditor me një komponent të fortë të praktikës profesionale (Dokument B.I. Për praktikën profesionale. Referencë 32.1) e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni dhe në mënyrë të veçantë Departamenti, mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit (Takime në institucion, Reference 33, 46.4). Për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, institucioni mundësonte përdorimin e metodave të shumëllojshme të cilat janë të përshtatshme me rezultatet e të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.

Handwritten signatures: D. Bay and M. Mose

<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët e angazhuar në këtë program studimi si dhe me studentët, GVJ konstaton se ka një angazhim të personelit akademik për të përshtatur format e mësimdhënies me natyrën e lëndës së zhvilluar (CV e personelit akademik, Referencë 20 & Takim me stafin akademik.)</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i metodave të mësimdhënies kryhet nëpërmjet (RVB, Takime në institucion):</p> <p>a. vlerësimi të Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit dhe/ose përgjegjësit të grup - lëndës përkatëse.</p> <p>b. vlerësimi të studentëve që kryhet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatit e tyre, si dhe focus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit</p> <p>c. vetëvlerësimi</p> <p>d. rezultateve të raporteve të KSBC.</p> <p>e. vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimi të Performancës që ngrihet nga Rektori (folloë-up).</p> <p>f. leksioneve të hapura, për një nga temat e planifikuara.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>GVJ nga takimi në institucion konstaton se ka pasur një bashkëveprim të studentëve, edhe pse në numër të vogël, gjatë seancave mësimore duke marrë pjesë në diskutim për çështjet e trajtuara. Gjithashtu, nga ana e personelit akademik synohet inkurajimi i punës në grup edhe pse vështirë të realizohet në një kurs me numër shumë të ulët studentësh.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies në programin e studimit bachelor në “Sociologji” nxisin studentët të mendojnë në mënyrë aktive duke i inkurajuar ata të punojnë edhe në grupe gjatë orëve të seminarit ku secili prej tyre mer një përgjegjësi për të përgatitur apo referuar një material. Një prej elementëve që programi inkurajon është të menduarit kritik dhe aftësimi të studentit të veprojë me autonomi në zgjidhjen e problemeve me të cilat ata përballen.</p> <p>Për këtë ata gjejnë mbështetje nga mësimdhënësit. (Rregullore e programit të studimit. Referencë 20 & Takim me stafin akademik.)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht</p>	<p>Procesi mësimor e shkencor në UET bën të mundur që të kenë në dispozicion hapësira të mjaftueshme dhe cilësore dhe të respektohet kërkesa për hapësirën e nevojshme për student (RVB, Vizita në ambientet ku zhvillohej procesi mësimor i programit BA-Sociologji). Godinat ishin të rikonstruara dhe mobiluara së fundmi, me sistem kondicionimi dhe sistem ëireless. Labororet janë të pajisur me mjetet didaktike të</p>

<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e cilësi të procesit mësimor.</p> <p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softëare-t përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor.</p> <p>Biblioteka e UET disponon një numër botimesh për drejtimet kryesore të programit si dhe hapsirat e mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët (Vizita në bibliotekë). Për të mundur përdorimin nga ana e studentëve, biblioteka qëndron e hapur nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00- 17:00. (RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Njësitë përgjegjëse të IT sigurojnë një sistem informatik të unifikuar në UET, Platformen LMS për mesimdhënie dhe janë të gatshëm e mbështesin në çdo moment studentët dhe pedagogët në raste nevojë. Sallat ishin të pajisura me kompjuter dhe projektor, me sistem fonie që të gjitha i vijnë në ndihmë personelit akademik dhe studentëve për mbarëvajtjen e procesit mësimor. (RVB, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë për programin e studimit bachelor "Sociologji" vihet në dispozicion të studentëve, dhe gjendet në librarinë dhe bibliotekën e UET. Në rastet kur literatura mungon në formë fizike, ajo është e siguruar gjithmonë në formë elektronike për studentët edhe në format pdf-je. (Vizita në Bibliotekë, Takimi me pedagogë)</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka e UET disponon një numër botimesh për drejtimet kryesore të programit si dhe hapsirat e mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët (Referencë 45, dhe Vizita në bibliotekë). Fondi i bibliotekës pasurohet çdo fillim viti me literaturën e përshtatshme të bazuar në kërkesat dhe nevojat e departamentit, në fund të vitit paraardhës aktualisht për lëndët e këtij programi studimi ekziston thuajse e tërë literatura e detyrueshme.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mesimdhënies dhe mesimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar aksesin në disa librari on-line për personelin akademik dhe studentët. Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (e përbashkëta bibliografike online).</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni ka në përdorim laboratorë mësimorë Informatike, të cilat janë të pajisura me PC, video projektor dhe mjete të tjera audio vizive, të cilat janë të përshtatshme në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve që i përdorin ato. Infrastruktura është e përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet e programit, edhe pse ky program ka të nevojshme programe specifike për përpunimin e të dhënave që sociologu grumbullon përmes pyetësorëve si programet SPSS, etj.</p> <p>Studentët kanë akses të vazhdueshëm në infrastrukturën e UET për të realizuar detyra të ndryshme të tyre gjatë programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mesimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit</p>	<p>Në zbatim të zhvillimeve dhe risive teknologjike institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor, si në sistemin MOODLE (UET LMS), system ky që bën të mundur që studenti</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Gjithashtu dhe personeli akademik përdor rregullisht e-learning. Po ashtu edhe studentët nxiten për ta përdorur sa më shumë, sidomos në kushtet e pandemisë së Covid-19 dhe zhvillimi të mësimdhënies virale. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS dhe Microsoft Teams. Përmes sistemit UET LMS pedagogët dhe studentët shkëmbejnë materiale, njoftime dhe çdo informacion që lidhet me lëndët. Studenti ka akses tek materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. (Guidë për pedagogët Referencë 46.2 dhe Guidë për studentët. Referencë 46.3)			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Është punë e zakonshme e personelit akademik të ofrojë asistencën e tij në orientimi e përzgjedhjen e temave të diplomës. Studentëve u ofrohet mentorimi përgjatë kërkimit që ato bëjnë dhe shkrimit të tezës. Studentë të nivelit Bachelor që kanë një mesatare mbi 8.5, mund të përfundojnë studimet e tyre me një temë diplome, studentët e tjerë e mbrojnë diplomën me provimin përfundimtar. (Referencë, 5)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Struktura e Universitetit European të Tiranës ka të ndërlidhura të gjitha njësitë përbërëse të strukturës në funksion të mësimdhënies dhe të koordinimit të aktiviteteve, përveç departamentit si njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Në Statutin e UET specifikon se departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, i cili përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron. Një tjetër njësi që promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies është edhe Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislativitetit në fuqi. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. (Reference 2,5)
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai	Personeli akademik i Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara

mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Nga ana e Departamentit dhe e Fakultetit ka një mbështetje të vazhdueshme në drejtim të kualifikimit duke u krijuar mundësi si në drejtim të pjesëmarrjes në aktivitete shkencore ashtu dhe në mobilitete në kuadër të projekteve europiane (Takime me personelin akademik dhe Referencë 28.5, 28.6)			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Përmirësimi i vazhdueshëm i veprimtarive të mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe adoptimi i metodave inovative ishte një nga objektivat e UET. Në këto veprimtari përfshiheshin shkëmbimet për krijimin e eksperiencës në universitete parterë, kjo në kuadër të programeve Erasmus+ KA195, si dhe trajnimeve ofruar nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.				
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe ndihmës akademik inkurajohen të testojnë dhe implementojnë metoda të reja të mësimdhënies, materiale, teknologji, si dhe literaturë të viteve të fundit në mënyrë që të përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> - Ndryshimin e vazhdueshëm i tendecave të tregut të punës. - Sugjerime gjatë takimeve të stafit në mbledhjet e departamentit - Sugjerime nga lektori i lëndës, gjatë trajnimeve, etj (Takime me personelin akademik) 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e UET dhe në rregulloren programit të studimit “Sociologji” si dhe në syllabuset e lëndëve përkatëse (Referencë 5, Referencë 7).
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstatoi se studentët njihen me elementët që lidhen me programin e studimit që në kontaktin e parë me pedagogët, të cilët u prezantojnë syllabusin dhe mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu studentët mund të informohen edhe nga sekretaria. (Takim me studentët).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme,	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	(RVB). Përgjithësisht mënyra e vlerësimit lidhet dhe me tipologjinë e lëndëve - Për lëndët e Tipologjisë I a. Provimi përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: 2 nga 30% = (60%) - Për lëndët e Tipologjisë II a. Provimi përfundimtar (40%) b. Provimi i ndërmjetëm (30%) c. Detyra e kursit (20%) d. Niveli i diskutimit në seminare (10%) (Referencë 5, Neni 24; Referencë 7 Pika 5.2)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	UET ndjek një procedurë vlerësimi të përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit, për sa i përket i përket vlerësimit dhe kontrollit të njohurive të studentit. Studenti vlerësohet dhe monitorohet në marrjen e njohurive përgjatë gjithë vitit akademik. Vlerësimet përfundimtare janë rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: -Për lëndët e Tipologjisë I a. Provimit përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: 2 (dy) nga 30% = (60%) -Për lëndët e Tipologjisë II a. Provimit përfundimtar (40%) b. Provimit të ndërmjetëm (30%) c. Detyrës së kursit (20%) d. Nivelit të diskutimit në seminare (10%) (Reference 7.1)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UET kishte në përdorim programin turnitin/ephorous, për të evituar plagjaturën e eseve dhe temave të diplomës që zhvillojnë studentët. Po kështu, UET në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) ka promovuar një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”. (RVB)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Zhvillimi dhe mbikëqyrja e provimeve në programin e studimit Bachelor në “Sociologji” kryhet nga titullari i lëndës i cili në vullnetin e tij mund të angazhonte edhe asistent lektorin i cili zotëron mjaft mirë kompetencat e lëndës. Komisionet ngriheshin vetëm në rastet e provimeve të diplomimit apo praktikave profesionale ose mesimore pedagog tjetër i cili njih dhe zotëron mjaft mirë kompetencat e lëndës. (Referencë 5 dhe 7)
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë	Procedura e zhvillimit të provimeve për programin e studimit Bachelor në “Sociologji” me profile ndjek një rrugëtim të tillë ku pas miratimit të tezës, kjo e fundit sekretohet duke mbajtur të fshtë emrin e studentit deri në momentin që pedagogu dorëzon rezultatet e provimeve pranë

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	sekretarisë mësimore. Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, e përcaktuar kjo sipas një grafiku që miratohet nga përgjegjësi i departamentit. (Referencë 5 dhe 7)			
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit (Referencë 7) dhe në syllabusin e çdo lënde. Nga studentët u tha që ato kanë seancat e konsultimit me profesorët ku marrin edhe përgjigje për paqartësitë e hasura.			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	UET ndjek një procedurë strikte për kryerjen e provimeve si dhe mbikqyrjen e tyre. Informacione të hollësishme mbi përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira gjenden në Rregulloren e UET. (Referencë 5 Neni 33).			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Dy javë nga data e zhvillimit të provimit, periudhe gjatë të cilës zhvillohen dhe seancat sqaruese, bëhet dorëzimi i vlerësimeve të provimit/eve. Vlerësimi për komponentët e tjerë dorëzohet në fund të semestrit, përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. (Takim me personelin, studentët, dhe sekretari mësimore)			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në UET funksiononte sistemi online për informimin e studentëve lidhur me vlerësimet. Gjithashtu në rast se student ka ankesa lidhur me vlerësimin, lind detyrim i kordinatorës së departamentit të përcaktojë një orar ku pedagogu mund të zhvillojë seancën sqaruese me studentin. (Referencë 5, Neni 32)			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Pas seancave sqaruese, nëse studenti mbetet i bindur se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohet Departamentit me kërkesë për rivlerësim. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm (Referencë 5,7, RVB)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Programi i studimit Bachelor në "Sociologji" me profile garanton pajisjen e të diplomuarve me njohuri bazë mbi teoritë dhe ka synuar përgatitjen e sociologëve dhe antropologeve me njohuri të përgjithshme në fushat përkatëse dhe duke mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike në fushën e sociologjisë, antropologjisë sociale etj. Nëpërmjet këtyre njohurive, ky program studimit përgatit individë për karrierë në sektorin privat, publik dhe organizata jofitimprurëse. Metodologjia e përdorur rrit edhe më shumë angazhimin dhe përgatitjen e studentëve në sfidën e përbashkët të thellimit të dijeve, duke synuar përgatitjen e tyre

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	<p>në sferën e sociologjise, antropologjise sociale etj, duke filluar që nga teoritë sociologjike mbi zhvillimin shoqëror, metodologjinë dhe teknikat e kërkimit sociologjik, antropologjik, zhvillimin njerëzor, institucionet dhe proceset shoqërore.</p> <p>Ky program mundëson tek studentët kompetenca në fushën e tyre të studimit mbi sociologjinë, aktorët social, zhvillimet e fundme në shoqëri; Kompetenca në sferën praktike, duke identifikuar problemet sociale, për të zhvilluar strategji praktike për gjetjen e zgjidhjeve. (Referencë 7, 14.1)</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde, çdo anëtar i personelit akademik bënte një përmbledhje për çështjet me rëndësi ku përfshinte këtu edhe studentin, gjithashtu dhe përgatitja e një detyre apo eseje, përcakton një formë të shqyrtimit të aftësive të tyre për matjen e indikatorëve në realizimin e lëndës. (Takim me personelin akademik dhe student)</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde, pedagogu analizonte me studentët çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit për lëndën, si dhe fokusohet në orientimin e studentëve për aplikimin e tyre në praktike. (Takim me personelin akademik dhe student)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik përdor metoda didaktike, përfshi këtu përdorimin e teknologjisë, me qëllim lehtësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmirësimin e kompetencave të studentëve në përdorimin e teknologjisë etj.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikatat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia për programin e studimit Bachelor në "Sociologji" me profile në mënyrën e realizimit, përmban dhe ofrimin e trajnimit profesional në mënyrë që studentët e diplomuar në këtë program të zotërojnë konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat komplekse të shoqërisë bashkëkohore. Gjatë takimeve në institucion, por edhe referuar (RVB-së, fq.32) klubi i sociologjisë "Marx" ka funksionuar nëpërmjet platformës TEAMS edhe gjatë kohës së pandemisë, ndonëse numri i studentëve ishte relativisht i kufizuar. Këtu duhet të ishte kushtuar me tepër vëmendje që studentët e Sociologjisë të terhiqeshin në aktivtete me interes për ta që të njihnin dhe promovonin avantazhet e profesionit të ardhshëm të Sociologut. (Reference 14,14.1)</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik ishte në mbështetje dhe e konsideronte të rëndësishëm ofrimin e mundësive të të punuarit në grup, punë me projekte apo detyra kurse të cilat kërkojnë një bashkëpunim midis tyre, pasi kjo gjë i ndihmon ata të rrisin aftësitë e tyre bashkëpunuese dhe komunikuese. (Reference 14.1, Syllabuset, Takimi me studentet)</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Personeli akademik nxit dhe zhvillon aftësinë për të drejtuar studime dhe kërkime të avancuara në mënyrë të pavarur, edhe përmes stimujsh financiarë, duke mbështetur dhe orientuar studentët drejt një profilizimi në të ardhmën. Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET, është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së personelit akademik, si dhe përfshirjes së studentëve në veprimtari kërkimore – shkencore edhe pse ky program nuk ka student të rregjistruar në dy vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	
<p>Kriteri 10. Personeli akademik</p>	<p>Shkëmbimet e personelit akademik dhe të studentëve të UET në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KA1, ishin evident, por nuk gjetëm studentë të këtij program studimi. (Reference 28.5)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në përfundim të kursit të plotë të studimeve bachelor, pra me shlyerjen e plotë të detyrimeve, studenti i sistemit trevjeçar, fiton DIPLOME Bachelor në “Sociologji” me profile: “Sociologji Politike”, “Antropologji Sociale”, “Administratë Publike”, “Marrëdhënie Publike”, “Gazetari” (Referencë 15). Çdo procedurë që ndiqet që nga aplikimi, miratimi i temës së diplomës, procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, e deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit, i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. (Referencë 10)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Lëndët që do të përfshihen si dhe formati i tezës së provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit përcaktohen që në fillim dhe vlerësimi për provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit bëhet nga një komision, përbërja e të cilit propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani. Studentët e programit të cilët në përfundim të studimeve të tyre kanë një mesatare mbi 8.5 kanë të drejtën që të realizojnë një tezë diplome (punim) ose me provim me shkrim (provimi përfundimtar). Studentët që i nënshtrohen provimit me shkrim, marrin orientime lidhur me grup lëndët dhe literaturën që duhet të shfletojnë. (Referencë 10)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	UET në lidhje me përmbajtjen e provimit të përgjithshëm përfundimtar, ka hartuar një procedurë të posaçme. Përmbajtja e programit të provimit përfundimtar bazohet në disiplinat kryesore të programit të studimit të ciklit të parë: 20% lëndë nga Kategoria A, 70% lëndë nga Kategoria B, dhe 10% lëndë nga Kategoria C. Nga viti akademik 2019-2020 pesha do të jetë 80% lëndë të kategorisë B dhe 20% lëndë të kategorisë C. (RVB) Teza e provimit përfundimtar hartohet sipas formatit të posaçëm ku rubrikat e vlerësimit janë të orientuara drejt pyetjeve cilësore dhe me zhvillim. (Referencë 7.1, A.IV.2.3;2.4)
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Personeli akademik angazhohet maksimalisht duke orientuar dhe ndihmuar studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: literatura, trajtimi i aspekteve metodologjike, përdorimi i metodave cilësore dhe/ose sasiore, mbledhja dhe raportimi i gjetjeve / të dhënave, përpunimi apo analiza e tyre. (Referencë 10, BII)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në rregullore janë parashikuar procedurat në lidhje me realizimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	provimit përfundimtar. Udhëheqësi në seancat metodologjike ka detyrim të trajtojnë çështje të cilat lidhen me objektin e studimit, diskutimi mbi rendësinë e punimit, etj. (Referencë 10).			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Vlerësimi bëhet me notë. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Studenti që kalon me sukses tezhën e diplomës/provimin e përgjithshëm përfundimtar pajiset me diplomën përkatëse.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim lëshohet diplomë DIPLOME Bachelor në "Sociologji" me profile: "Sociologji Politike", "Antropologji Sociale", "Administratë Publike", "Marrëdhënie Publike", "Gazetari" në Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të Universitetit European të Tiranës (UET) referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (Referencë 15,1,2, 3.)			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit "Sociologji" sipas profileve me kërkesë të tij dhe kur kashlyer të gjithë detyrimet që ka me IAL-në.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Gjatë vizitës, GVJ, konstatoi se institucioni disponon një databazë të të dhënave të studentëve, por ky informacion duhej të përpunohej me të dhëna statistikore të përditësuara sipas statusit që studentët kanë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga vizita në institucion, bisedat me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, GVJ konfirmon se UET ka rregulla të përcaktuara për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe një njësi përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, atij ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ (Referenca 11. Rregullore për Burimet Njerëzore). Për secilin person të angazhuar në UET, Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të Dosjes Individuale të stafit (Referenca 44. Format dosje staff akademik).			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Në nivel institucioni është hartuar Rregullorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore është njësi përgjegjëse për zbatimin e tij në rekrutimin e një stafi të kualifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore lidhur me punësimin. (Referenca 11. Rregullore për Burimet Njerëzore).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Kriteret shpallen në faqen zyrtare të UET, rrjetet sociale dhe Gazetën e UET "Liberale", etj. (Referenca 11.1 Shembull thirrje për staf akademik). Nga bisedat e GVJ me stafin akademik apo edhe me atë menaxherial, doli qartë se rekrutimet ishin profesionale dhe të zgjedhura me kujdes. Një pjesë e mirë e stafit akademik vinte me diploma nga jashtë vendit, dhe stafi në pozita drejtuese menaxheriale njihen si personalitete publike.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek një proces rekrutimi dhe vlerësimi konform rregullave, duke asistuar njësitë bazë, Departamentin e Shkencave Sociale të Aplikuara dhe Fakultetin e Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare, në plotësimin e vendeve vakante (Referenca 11. Rregullore për Burimet Njerëzore). Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit (ëëë.uet.edu.al). UET ndjek një politikë rekrutimi bazuar në vlerësimin sipas meritës bazuar dhe takimi i GVJ në institucion me stafin akademik dhe administrativ e konfirmoi këtë nivel profesionalizmi, sikurse edhe shqyrtimi i dokumentacionit të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe CV e stafit akademik (Referenca 20. CV e stafit akademik).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2


Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Vizita u krye në mjediset e reja të UET të cilat garantonin mundësi të përshtatshme për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Kampusi i ri garanton kushte infrastrukturore bashkëkohore të cilat krijojnë mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar në programin e studimit, zyra dyshe për personelin akademik të pajisura me kompjutera, sistem ngrohje-ftohje, akses në internet, biblioteka, etj. (Referenca nr.42 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit).</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Ajo çfarë u evidentua gjatë bisedës me drejtuesit dhe stafin akademik, si dhe referuar CV-ve të tyre ishte motivimi i stafit për zhvillimin e profesional në vazhdimësi (Referenca 20. CV e Stafit akademik). Kjo tregon që institucioni mbështet kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit, sikurse janë aktivitetet e përvitshme shkencore të zhvilluara në Prill në Ditët e Studimeve Shqiptare, si dhe botimi i revistave shkencore Polis dhe në anglisht "Sociological Analysis". Po ashtu, UET mbështet kualifikimet jashtë vendit, apo trajnimet e stafit në UET me ekspertë të ndryshëm (Statuti UET, neni 6, pika 6.3; Referenca nr. 2). UET mbështet angazhimin e personelit në debate publike mbi çështje të zhvillimit ekonomik, social, politik, shkencor, edukimit, etj</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare dhe vizitat në universitetet e tjera europiane në kuadrin e projekteve ndërkombëtare me fokus mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, shërbejnë si një mënyrë kualifikimi profesional, konkretisht projektet Erasmus+ si KA2, etj. (Referenca 28.5 Lista e projekteve ku është përfshirë stafi i UET). UET ka organizuar trajnime specifike sidomos për aplikimin e platformave online në situatën e pandemisë së Covid-19, përgjatë semestrit të dytë 2019-2020 dhe 2020-2021 (Referenca 46.4 Video trajnime mbi sistemin teams dhe LMS).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Drejtuesit e institucionit gjatë bisedave konfirmuan mbështetjen për stafin akademik dhe cilësia e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është dëshmia e këtij angazhimi optimal të burimeve njerëzore. Stafi akademik në këtë program studimi vjen me një përvojë akademike të gjatë brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me</p>	<p>Institucioni siguron mjediset të përshtatshme për mësimdhënie në kampusin e ri në rrugën Xhanfize Keko në Tiranë, kampusi ku GVJ kreu vizitën dhe takimet sipas agjendës. Mjediset janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, laboratorë, zyra për stafin, biblioteka, mjedise sportive dhe mbështetëse sipas parametrave</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	bashkëkohore të programit të studimit (Mjediset u shkelën nga GVJ gjatë vizitës në institucion, Referenca 42).			
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, si smartboard dhe sisteme projektimi dixhital, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor të programit të Sociologjisë. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjetë ifi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, skaner etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (GVJ i konstatoi gjatë vizitës në institucion). Stafi akademik konfirmoi përdorimin e tyre në mësimdhënie dhe kjo teknologji ishte një tjetër motivim për ta.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliët apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Programi i studimit Bachelor në Sociologji ka mjedise të përshtatshme dhe mjetet e nevojshme dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifike për mënyrën se si është organizuar dhe zbatohet programi. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme audio-vizive për plotësimin e kërkesave të kurrikulës së Sociologjisë. UET përdor sistemin MOODLE (UET LMS) për lehtësimin e menaxhimit të informacionit mes studentëve, pedagogëve dhe stafit mbështetës administrativ (Referenca Nr.46-Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS nr.46.1, 46.2, dhe 46.3).			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	UET ka 7 laboratore informatike të pajisura mjete të teknologjisë së informacionit, të përshtatshme për formimin profesional të sociologëve. Laboratorët janë të aksesueshëm si nga stafi akademik edhe studentët, të cilët ata i përdorin gjatë lëndëve të ndryshme sociologjike dhe punimit të detyrave të kursit.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Gjatë bisedave me drejtuesit e institucionit si dhe stafin akademik, konfirmohet se UET, përveç kapaciteteve të tij, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera për të plotësuar të gjitha nevojat e lidhura me veprimtaritë praktike të studentëve (Referenca 32. Lista e subjekteve bashkepunues dhe Referenca 34. Marrëveshjet e bashkepunimit). Kjo është një nga pikat më të forta të UET që përmes rrjeteve të bashkëpunimit me institucionet e tjera përmbush edhe mësimin bashkëkohor, edhe lidhjen e teorisë me praktikën.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ vizitoi Bibliotekën e Kampusit universitar me një hapsirë 35 m2 (RVB) e vende leximi ku janë të arkivuara revistat shkencore, punimet e konferencave, periodikët e fushave të ndryshme dhe kompjutera për aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit. Hapësira është e vogël për një universitet si UET, ndonëse program i studimit në Sociologji ka pasur një

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	numër te kufizuar studentësh për të cilët është e mjaftueshme (Referenca 42. Infrastruktura ne funksion te programeve te studimit).			
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e UET është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja në përputhje me natyrën e programit të studimit (Referenca 45. Inventari i teksteve ne fushen e programit te studimit). GVJ konstatoi se Biblioteka ka nevojë të pasurohet me botimet e fundit shqiptare dhe të huaja në fushën e Sociologjisë. Në kushtet që UET zotëron shtëpinë botuese UET pres, mund të mbështesë publikimet e stafit akademik efektiv, si punimet e doktoraturave apo studime në fushën e Sociologjisë.			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	UET u krijon kushte studentëve për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online si bibliotekën dixhitale SAGE, EBSCO dhe Questia, bibliotekë që ofron orientim dhe ndihmë në kërkimin e artikujve, punimeve dhe librave dixhitale. Këto Biblioteka online sjellin një qasje inovative për zhvillimin e të gjitha fushave të shkencës, teknologjisë, shkencave shoqërore, arteve dhe shkencave humane. GVJ konfirmon funksionimin e tyre nga vizita në bibliotekë (Biseda me bibliotekaren per te konfirmuar RVB).			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Bibliotekat janë të pajisura me kompjutera për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare. Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesat apo dëmtimin e librave (Referenca 42. Infrastruktura ne funksion te programeve te studimit). Platforma është plotësisht e automatizuar dhe përdoruesit mund të rezervojnë ose së mund të bëjnë kërkesë për rezervimin e librit sapo të kthehet në bibliotekë. GVJ e testoi kete gjë në bibliotekën e UET, e cila është pjesë e rrjetit COBISS për vendet e EJL.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Nga biseda me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit u konfirmua që në çdo viti akademik, secili departament propozon një listë me libra që sigurohen për bibliotekën dhe janë të përfshirë në literaturën e programit mësimor Bachelor në Sociologji. Pasurimi periodik i fondit të bibliotekës, sikurse dhe shtimi i aksesit në bibliotekat online, janë pjesë e politikave institucionale te UET (Referenca 45. Inventari i teksteve ne fushen e programit te studimit).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare shërbimi për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Interesante ishte që orari i Bibliotekës ndryshonte nga ai i administratës pasi ishte e hapur përgjatë gjithë ditëve të javës, e diela pushim dhe me orare nga 9am deri në 8 pm, nga e hëna në të premte, edhe të shtunën deri në 5 pasdite, në funksion të studentëve dhe stafit akademik, ky është një tjetër aspekt pozitiv i UET, i konfirmuar nga biseda me bibliotekaren dhe stafin akademik. (Rereferenca 45.1)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UET disponon një sistem për menaxhimin e të dhënave të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim (UMIS) (Referenca 46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS). UMIS ju mundëson studentëve të informohen në kohë reale lidhur me të gjitha aktivitetet e tyre nga notat, komunikimin me pedagogët, oraret, etj. Stafit akademik dhe studentët gjatë takimeve me ta në institucion, konfirmuan vlefshmërinë e platformës UMIS. GVJ gjatë takimit me sekretarinë mesimore konstatoi se UET zbaton administrimin e informacionit në mënyrë korrekte.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konfirmon funksionimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit UMIS. Ai përfshin komunikimin online për aktivitetin e personelit akademik dhe administrativ, atë të burimeve njerëzore apo sekretaritë, si dhe komunikimin me partnerët e UET në këtë program studimi. UMIS administrojnë si portalin e studentëve, edhe atë të pedagogëve ku përfshihet gjithë informacionin për aktivitetin shkencor të stafit akademik, aktivitetin mësimor deri tek hedhja e notave të studentëve në sistem, etj.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit të mësimdhënies UET LMS është nga sistemet bashkëkohore i azhurnuar me të gjithë informacionin bazë. Aty behet regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesimi në literaturën e lëndëve që ata ndjekin, regjistrimi i të gjithë pedagogëve në lëndët e veta; vlerësimet, pyetësorët, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Aksesit sigurohet i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale në platformat online për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit, të cilët pajisen me adresat e internetit të universitetit që sapo rregjistrohen apo për personelin me lidhjen e kontratës së punës me UET (Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Takimi me drejtuesit, stafin akademik dhe studentët).
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit të UET ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv në platformën LMS (Learning Management System) dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog (njoftimet, vlerësimet për detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.). Sistemi LMS ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, pasi studenti merr gjithë literaturat dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Sikurse doli nga biseda me stafin dhe studentet, që me regjistrimin e tyre pajisen me adresat e e-mailit të universitetit, përmes të cilave mundësohet komunikimi interaktiv

	Referenca 46. Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS).			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të informacionit si më sipër, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët. Ky përbën edhe një avantazh të UET që lehtëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik / administrativ dhe studentëve duke shmatur vonesat e panevojshme.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e UET: ee.uet.edu.al është e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët dhe personelin akademik. GVJ kontrollon informacionin e disponueshëm edhe në gjuhën angleze: https://uet.edu.al/en/ në lidhje me fakultetet dhe shërbimet që ofrohen nga UET, aktivitetet e ndryshme si konferenca, leksione të hapura me personalitete vendase dhe të huaja, mbi programet, silabuset e lëndëve, etj. Studenti në intervistë me GVJ, që ishte kthyer nga studimet jashtë vendit, informacionin e kishte marrë përmes faqes së UET dhe pastaj kishte vendosur të vazhdonte studimet në UET.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni, përmes një strukture të veçantë si Zyra e Financës harton çdo vit raportet me të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si dhe të veprimtarive që lidhen me kërkimin shkencor dhe kualifikimin e personelit. Mbi bazën e tyre bëhen parashikime për periudha afatmesme dhe miratohen nga bordi i aksionerëve të UET. Në raport përcaktohet për çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrime fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e financiare duke u kryer vetëm nëpërmjet sistemit bankar, sigurojnë transparencë të plotë. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë (Referenca Nr. 50. Te ardhura dhe financime te ndryshme).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	Plani i financimit përmban të dhëna mbi financimin e burimeve njerëzore, shpenzimeve operative, për bibliotekën dhe detyrimet financiare e grantet (Referenca 50. Te ardhura dhe financime te ndryshme). Raporti Financiar Vjetor Institucional paraqet të dhëna mbi strategjinë dhe objektivat, aspektet ekonomike, sikurse dhe literaturën që përcaktohet nga çdo pedagog i departamentit, aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet e përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit etj. Referuar diskutimeve me stafin që angazhohej në disa programe studimi, p.sh.pedagogu i Metodave të Kërkimit, etj., po

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	ashtu edhe faktit që kostot e infrastrukturës janë të ndara midis disa programeve, praktikisht është e pamundur të hartohen raporte të veçanta financiare për çdo program studimi.			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni kryen auditim të përvitshëm mbështetur në kërkesat e Ligjit 80/2015, Neni 116 dhe standardet kombëtare të kontabilitetit. Institucioni ka krijuar njësinë e auditimit të brendshëm në përputhje me kuadrin rregullator të tij. Në përfundim të procesit të Auditimit të Brendshëm, dokumentohet situata financiare në një raport që i dërgohet drejtuesit/Administratorit të UET. Auditimi i Jashtëm, duke filluar nga viti 2017, kryhet nga kompania audituese “Deloitte Albania”. Raportet e Auditimit të Jashtëm depozitohen në faqen e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe janë lehtësisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara (Referenca 49. Te dhena mbi koston per student).			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon buxhetimin për vitin e ardhshëm. Zyra e Financës është përgjegjëse për dokumentimin e bilanceve financiare në përputhje me aktet ligjore duke respektuar formatet e kerkuara të raportimit të indikatorëve kryesorë. Çdo vit treguesit financiarë si dhe zbatimi i buxhetit bëhen pjesë e analizës në bordin e Administrimit (Referenca nr.49 dhe nr. 50).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	UET pasqyron saktë bilancet financiare, që tregojnë qëndrueshmërinë e financimit të tij. Nga pasqyrat financiare ndër vite, raportet e auditimit, opinionet dhe sugjerimet e Bordit, rezulton se UET ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete që garantojnë gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Raportet financiare evidentojnë se burimi kryesor i financimit janë të ardhurat nga tarifat e studentëve. Fakti që programi Bachelor në Sociologji ka pasur një numër në zbritje studentësh, duke u shuar gradualisht, tregon se ky program studimi është mbështetur nga të ardhurat e siguruara nga studentët e programeve të tjera të studimit ku stafi akademik është i angazhuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Mass
Elway

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UET ka procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, të përcaktuara ne legjislacionin ne fuqi, Statutin dhe Rregulloret e UET (Referenca 27 dhe Referenca 7. Rregullore Mesimore Bachelor ne Sociologji). Nga shqyrtimi i dokumentacionit te sekretarise mesimore dhe biseda me studentet, GVJ konstatoi se institucioni respekton legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore Informacioni mbi keto procedura publikohet online në broshurën informuese Guida UET dhe sqarohet në institucion per çdo te interesuar.</p>			
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Neni 42 i Rregullores së UET ‘Të drejtat e studentit’ garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët që aplikojnë në UET për studime ne programin e studimit Bachelor në Sociologji. Politikat dhe procedurat mundësojnë që studentët të gjejnë një mjedis mbështetës ne UET (Referenca 12. Mbi funksionimin e Zyres se Karrieres dhe Keshillimit ndaj studentit).</p>			
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Sipas verifikimit të GVJ me sekretarine mesimore, studentët e programit Bachelor ne “Sociologji” me profile , jane rregjistruar duke respektuar kriteret, procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes sipas legjislacionit ne fuqi. Per shkak te numrit te vogel të studenteve 14 ne vitin akademik 2018-2019 dhe 3 studentë ne vitin akademik 2019-2020, ka nje student te transferuar nga programi i studimit Marredhenie Nderkombetare viti i pare me 60 ECTS, ende i pa diplomuar; 4 studente te ç’rregjistruar dhe vetem 6 te diplomuar (Referenca 28. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, Neni 35).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>UET publikon ne faqen online kriteret për përzgjedhjen e studenteve kandidatë në programin Bachelor në Sociologji, kriteret te percaktuara ne Rregulloren per Pranimet e Studenteve. Tradicionalisht UET ben nje pune paraprake me shkollat e arsimit te mesem ne gjithe vendin per tua bere te qarta ato dhe per te ftuar te sapo diplomuarit te vazhdojne studimet ne UET.</p>			
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>UET nuk ka kriteret specifike për studentet e ketij programi studimi Bachelor në Sociologji, jane ato te percaktuara ne Rregulloren e UET per Pranimet e Studenteve (Neni 11) te cilat nga verifikimi i GVJ me sekretarine mesimore kane respektuar legjislacionin ne fuqi. Kriteret dhe kerkesat e pranimit ne programin e studimit Bachelor ne Sociologji parashikojne edhe studente te huaj dhe jane lehtesisht te aksesueshme ne: https://uet.edu.al/.</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UET vë në dispozicion të publikut, nëpërmjet faqes zyrtare, mediave sociale, fletëpalosjeve në ambientet e institucionit qe ne hyrje te tij, informacionin në lidhje me kriteret e programit të studimit Bachelor në Sociologji. Nga biseda me studentet kjo gje doli fare qarte (Referenca 48. Politikat e Prezantimit dhe Promovimit te UET online).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.2				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Përmes koordinatores së departamentit dhe sekretarisë mësimore, studentët informohen në detaje lidhur me vlerësimet për lëndët gjatë gjithë vitit akademik, për numrin e krediteve të akumuluar për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, sipas Ligjit 80/2015 (Referenca 7. Rregullore Mesimore Bachelor ne Sociologji). Sistemi i menaxhimit të informacionit LMS online mundeson marrjen e informacioneve për notat dhe kreditet e fituara.			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme dhe transferimeve të percaktuara në Rregulloren e UET, Neni 35. Studenti i kontaktuar në UET ishte shembull i transferuar nga universitetet jashtë vendit që po perfundonte studimet në Bachelor ne Sociologji me profile në UET. Gjatë takimit me të u informuan në detaje. (Referenca nr.28. Dokumenti mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin).			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve të parashikuara në Kreun V të Rregullores së UET, Neni 23, 24 janë përcaktuar menyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve, e drejta për të hyrë në provim pasi studenti ka ndjekur mjaftueshëm orët e leksioneve dhe seminareve, zhvillimi i provimeve, komunikimi i vlerësimit. Krahas Rregullores, çdo pedagog në orën e pare të lëndës, prezanton programin dhe u ben të qarta studenteve format e vlerësimit të dijeve e aftësive sikurse dol in ga diskutimi me stafin akademik të programit të studimit (Referenca nr.19. Syllabuset e lendeve).			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e UET, Neni 39, parashikon kriteret e vlerësimit të dijeve e aftësive për diplomimin e studentëve të programit të studimit BA në Sociologji (Referenca 5. Rregullorja e UET). Institucioni respekton kuadrin ligjor ku përcaktohet se diploma Bachelor fitohet pas provimit final me shkrim ku përmbahen çështjet kryesore të të gjitha lëndëve të planit mësimor. Për studentet me mesatare të larte u njihet e drejta për temë diplome. Departamenti ka ndërtuar programin e provimit të formimit (Referenca 10. Dokumenti mbi punimin e diplomës dhe disertacionit). Deri tani vetem 6 studentë janë diplomuar në këtë program studimi (Statistikat e sekretarisë mesimore).			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UET, si çdo institucion privat, përpara fillimit të çdo viti akademik zhvillon ditët e hapura për studentët të cilët kanë interes të studjojnë në UET të mbështetur në një plan vjetor (Referenca 27. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin). UET organizon takime nëpër gjimnazet në gjithë vendin me grupe pedagogësh dhe studentësh ku prezantohen detajet nga secili program studimi, si dhe fton maturantët në mjediset e UET, shpërndan fletëpalosje dhe aktivitete online. (https://uet.edu.al/keshillimi-i-karrieres/)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	UET e ka bere tashme tradite informimin e studentëve që në fillim të vitit akademik për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit te studimit Bachelor ne Sociologji. Nga biseda me Përgjegjësën e Departamentit dhe personelin akademik, ky informacion jepet qe ne javen e pare te informimit. Po ashtu, me fillimin e programit mësimor, pedagogu koordinator i departamentit orienton studentët për të gjithë komponentët që kanë lidhje me organizimin e programit të studimit. Krahas kontakteve te drejtpërdrejta, studentet dhe kushdo qe eshte i interesuar, marrin informacion në hollin e institucionit me materialet informuese me të dhëna të detajuara për programin e studimit. Faqja e internetit e UET siguron informacion te hollesisshem për programin e studimit Bachelor ne Sociologji.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët e programit të studimit Bachelor në Sociologji informohen në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve përkatës (Referenca 7. Programi mesimor i BA Sociologji). Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës dhe programi lëndor (Referenca 19 Syllabuset e lëndeve), ku janë specifikuar temat me literaturën e detajuar dhe format e vlerësimit të dijeve.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Përmes takimeve në institucion, GVJ konfirmon veprimtarine e institucionit permes Zyrës se Keshillimit te Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, për orientimin drejt tregut të punës, e cila pasqyrohet edhe ne faqen zyrtare https://uet.edu.al/keshillimi-i-karrieres/ Po ashtu, Bordi i Tregut te Punes luan nje rol te rendesisshem ne kete drejtim. UET ka krijuar nje tradite me panaiet e punes me rrjetin e bashkepunetoreve me të cilet ndermjeteson edhe per praktikat profesionale te cilat jane porta e pare e orientimit ne tregun e punes (Referenca nr.12. Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit).
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në funksion të realizimit të procesit mësimor, Koordinator i Departamentit, dhe sekretaria mësimore u vene në dispozicion studentëve informacion të përditësuar mbi gjithë komponentët e zhvillimit dhe organizimit te procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet, si nëpërmjet komunikimeve elektronike, sistemit LMS, nëpërmjet email-it zyrtar, ashtu dhe përmes komunikimeve të drejtpërdrejta me ta (Referenca nr.9. Dokumenti mbi funksionimin e sekretarise mesimore).
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit LMS është funksional dhe realizon në kohë reale dhe në çdo vend që mund të jenë

permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	studentët, informacion të detajuar në lidhje me programin e studimit, lëndët sipas viteve dhe semestrave, kreditet, rezultatet e marra (notat) etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nok përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Sipas Nenit 19 të Rregullores së UET, regjistrimi i studentëve bëhet në katër regjistra: themeltar, i amzës, i diplomave, dhe i lëndë. GVJ, nëpërmjet vizitës në Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Regjistrimit të Studentëve, shqyrtoi të dhënat e hedhura në Regjistrat standard në lidhje me studentët e regjistruar në çdo vit akademik në programin e studimit Bachelor në Sociologji, si dhe numrin e të diplomuarve që ishte vetëm 6 studente (Referenca nr.27 Cilësia në hyrje dhe dalje për programin; Referenca nr.29. Monitorimi i ecurisë së studentëve dhe punësimit të tyre).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konfirmon se Sekretaria Mësimore e UET mban në mënyrë të rregullt dhe pa gabime nëpër 4 regjistra një bazë të dhënash të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Sociologji, studentët e transferuar apo ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, si edhe ata që janë çregjistruar. Ky informacion evidentohet lehtësisht sepse numri i studentëve ishte relativisht i ulët, në kufijte e normave të lejuara për hapjen e programit të studimit, përkatësisht 11 studentë (2018-2019), 17 studentë (2019-2020) dhe 12 studentë (2020-2021), kurse transferime kishte vetëm 3 studentë në vitin akademik 2018-2019 (Referenca Tabelat përmbledhëse statistikore të ofruara nga Sekretaria Mesimore gjatë bisedës me to).
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Depozitimi i të dhënave të mësipërme për secilin student është në Sekretarinë Mësimore të Institucionit, personeli i së cilës shfaq disponibilitet maksimal për të na njohur me gjithë dokumentacionin e detajuar që kishin për çdo student, të dhënat për ecurinë e tyre që nga pranimi deri në diplomim. Të dhënat janë të regjistruara si në regjistrin e të dhënave në letër, ashtu edhe në formë elektronike (Referenca 9. Dokumenti mbi funksionimin e sekretarisë mesimore).
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga verifikimet e të dhënave të studentëve në Sekretarinë Mësimore, GVJ konkludon se nëpërmjet përdorimit të sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit dhe portalit studentor, ku gjenden të dhënat mbi: notat dhe rezultatet e provimeve, etj., këto informacione të lidhura si me rezultatet e tyre akademike, edhe me të dhëna të tjera me rëndësi për ta, janë të sigurta dhe pasi përpunohen, kalojnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Mose
Pray

	për drejtuesit e institucionit (Referenca 9. Dokumenti mbi funksionimin e sekretarise mesimore).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në dokumentet e shqyrtuara dhe në takimin me Zyren e Keshillimit dhe Karrieres, GVJ gjen raporte për profilin dhe cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe mosrealizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi pasi pritshmerite ishin me të medha dhe program po shkonte drejt mbylljes sepse nuk kishte terhequr mjaftueshem studente. Zyra e Keshillimit dhe Karrieres në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit lidhur me punësimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Në Statutin e UET (neni 16, 19, dhe 51) dhe në Rregulloren (neni 22) e Institucionit janë parashikuar përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse si në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës, në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe mbledhjet e Departamentit, një herë në muaj janë të hapura edhe për studentët (Referenca 2. Statuti i UET dhe Referenca 5. Rregullore e UET).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje garantohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse, sikurse u shtjellua të Kriteri 1 më sipër. Po ashtu, vlerësimi i tyre mbi procesin akademik kryhet edhe nëpërmjet zhvillimit të pyetësorëve në mënyrë periodike për të marrë vlerësimet e tyre të cilat pasi diskutohen në departament pasqyrohen në raportet periodike. Pjesë e Grupit të Reaportit të Vlerësimit të Brendshëm ishte edhe një përfaqësues i studentëve (sikurse rezultoi nga takimi i GVJ në institucion).
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni ka unifikuar kurrikulat duke respektuar kuadrin ligjor dhe në këtë mënyrë edhe ngarkesën e studentëve. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa në kredite bëhet sipas rregullave ku çdo semestër ka ngarkesë 30 ECTS dhe në tre vitet e Bachelorit realizohet ngarkesa prej 180 ECTS. Në programin Bachelor në Sociologji me profile, studentët e vitit të parë me 30 ECTS kalojnë në vitin e dytë dhe me 60 ECTS në vitin e dytë kalojnë në vitin e tretë. Në semestrin e dytë të vitit të tretë, studentët kanë ngarkesë të ulët me 3 lëndë, që t'u krijohen lehtësira për praktikën profesionale dhe mbrojtjen e diplomës. Institucioni lehtëson njohjen e lëndëve që janë të transferueshme në rastet kur studentët vijnë nga jashtë shtetit ose nga Universiteti i Tiranës, një rast i transferuar nga Fakulteti i Historisë (Referenca 28. Dokumenti për

	Transferimet dhe Njohjen e studimeve).			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve që realizohet çdo semestër, dy herë në vit, me secilin grup, për të gjitha lëndët dhe pedagogët, si dhe për syllabuset (Referenca 7 Rregullore e Programit të studimit). Rezultatet e pyetësorëve u komunikohen me email pedagogëve individualisht dhe përdoren si nga pedagogët, Departamenti dhe strukturat e tjera për të përmirësuar mësimdhënien. Studentët njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies. Studentët e këtij programi studimi nuk kanë shprehur ndonjë sugjerim për ndryshime që të merret parasysh nga organet drejtuese.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces që ju bëhet me dije studentëve që në fillim të çdo lende, i cili shprehet në Rregulloren e institucionit (Referenca 7. Rregullore e Programit të studimit, neni 24, 27, 32) dhe në syllabusin e secilës lëndë (Referenca 19. Syllabuset e lendeve). Sekretimi i provimeve, sqarimi për vlerësimin, mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komisioni posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Dhënia e argumenteve për vlerësimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë, zhvillimi i seancave sqaruese dhe rishikimi i vlerësimit janë tregues i vëmendjes së institucionit ndaj transparencës me studentët gjatë procesit të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UET ka krijuar strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, Sekretaria Mësimore,, Zyra e Alumni dhe Zyra e Këshillimit dhe Karrierës me të cilët GVJ pati takime ne institucion. Ato kryejnë funksione në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të UET, për shërbimet e kërkuara nga studentët që nga regjistrimi, deri në diplomimin (Referenca 7. Rregullore e Programit të studimit; dhe Referenca 12. Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Te gjitha shërbimet e strukturave administrative ne UET si dhe zyrave ne shërbim te studentit janë tregues i një sistemi të posaçëm për informimin, këshillimin dhe përparimin e studentëve. GVJ konfirmon se studentet marrin gjithë shërbimet e kërkuara që nga informimi, këshillimi dhe asistimi për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, si dhe për aktivitete e shërbime

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	brenda e jashtë UET, për mbarëvajtjen e jetës së tyre studentore.			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	UET ofron shërbimin e këshillimit për karrierën për studentët dhe në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen të gjitha veprimtaritë e organizuara nga Zyra e Alumnit dhe Zyra Keshillimit dhe Karrierës (Referenca nr.12. Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit). Studentët orientohen për institucionet ku mund të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale, nëpërmjet koordinatorit të departamentit, si dhe pedagogut të përcaktuar për të mbikëqyrur lëndën e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi. Krahas tyre, studentët këshillohen nga stafi akademik në orët e tyre tutoriale për çështje të procesit mësimor apo të tjera (Referenca 27. Cilesia në hyrje dhe dalje për programin).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Alumnit dhe zyra e Keshillimit të Karrierës në UET mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta (Referenca nr.12. Dokumenti mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentit). Studentët e diplomuar ftohen në aktivitete ku Alumnit ndajnë përvojat e tyre dhe shkëmbejnë informacione për tregun e punës (Http://uet.edu.al/nea/Uet-alumni-10-vite-me-pas/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në Statutin e UET (Neni 11 dhe 16) dhe Rregulloren e institucionit, sigurimi i brendshëm i cilësisë është parashikuar në përputhje me dispozitat e legjisllacionit në fuqi. Procesi i vazhdueshëm monitorimit dhe vlerësimit për përmirësimin e cilësisë është edhe në objektivat strategjike dhe vizionin e institucionit. Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) (Referenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC). Një tjetër strukturë është Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, që merret si me zhvillimin e strategjive dhe udhëzimeve për rritjen e cilësisë, edhe me monitorimin e zbatimit të tyre nga Departamentet dhe strukturat administrative në UET. GVJ

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	nga takimi me Përgjegjesen e kesaj zyre ne institucion konfirmon procedurat standarde te UET për vlerësimin e cilesise dhe promovimin e stafit akademik të përcaktuara në Rregulloren e tij (Referenca 2. Statuti UET; Referenca 8. Dokumenti F VII Per sigurimin e brendshem te cilësisë).			
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në Statutin e UET, në Rregulloren e tij, si dhe në veprimtarine e KSBC, Zyres se Standardeve dhe Cilësisë, konkludohet se institucioni e ka funksional sistemin e brendshem të cilësisë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konfirmoi procedurat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, tregon se UET konsultohet me aktorë të jashtëm për përmirësimin e cilësisë (Referenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC).			
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga ASCAL. Programi i studimit Bachelor në Sociologji akreditohet për herë të parë me daljen e të diplomuarve të parë nga ky program. GVJ konfirmon se KSBC dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë bashkëpunojnë ngushtë me njësitë e tjera të UET si burimet njerëzore, zyrën e Alumnit, Keshillimit dhe Karrierës dhe bashkëpunëtorët e jashtëm për vlerësimin e cilësisë (Takimi me GVB ne institucion, me perfaqesuesit e stafit akademik, studenteve, administrates; Referenca 8. Dokumenti F VII Per sigurimin e brendshem te cilësisë; dhe Referenca 54. Urdhër i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 534, datë 07.09.2018 Për riorganizim i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Sociologji-Antropologji Sociale").			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjstive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ndjek procedura periodike për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në Sociologji sipas nje Plani Veprimi. Gjatë vizitës në UET, GVJ konfirmoi se ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë si pyetësorët për vlerësimin e pedagogëve dhe studentëve që aplikohen periodikisht për përmirësimin e procesit mësimor, duke krijuar kulturën e rritjes së cilësisë në nivel institucional (Referenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëstive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Nga takimet me Dekanin, Përgjegjesin e Departamentit dhe stafin akademik, GVJ konfirmoi se Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamenti janë strukturat kryesore që merrem me shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit te studimit


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	<p>Bachelor ne Sociologji. Zyra e Kurrikulave u jep forme formatimit te tyre sipas standardeve shteterore ne fuqi (Referenca 13. Dokumenti E VIII. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave). Në funksion të garantimit të cilësisë, Departamenti ka caktuar përgjegjësit e gruplëndëve dhe koordinatorët e programeve te cilët kanë detyra specifike që lidhen me çështjet e rishikimit të kurrikulës, përgjegjësi të parashikuara në Vendimin për caktimin e Koordinatorëve të programeve të studimit, ndonëse koha 3 vjeçare e zbatimit të këtij programi nuk ka lenë hapësira për rishikime (Referenca Nr. 36. Vendim për emërimin e koordinatorit të programit të studimit). Institucioni ka hartuar edhe Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë 2017-2022 (Referenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashërshme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>UET ka krijuar nje tradite që Komisioni i Sigurimit të Brendshem të Cilësisë përgatit raportet e përvitshme të vlerësimit pas shqyrtimit te rezultateve te programeve të studimit, rezultateve te pyetesoreve me studentet, etj. Këto raporte pas diskutimit në nivel departamenti, i percillen organeve vendimarrëse te UET (Referenca nr. 13. Dokumenti E VIII. Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave). GVJ nga biseda me pergjegjesin e departamentit, stafin akademik dhe Grupin e hartimit te Raportit te Vleresimit te Brendshem, konkludoi se Departamenti pas tre viteve te zbatimit te programit te studimit Bachelor ne Sociologji, konfirmoi se krijimi i 5 profileve nuk ishte funksional dhe po shqyrtonte riformatimin e tij ne nje profil te pergjithshem "Sociologji".</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Instrumentet që përdor UET për vlerësimim e ecurisë dhe mbarëvajtjes se programit të studimit janë raportet e Komisionit të Sigurimit të Brendshem të Cilësisë i cili kryen vlerësime periodike të procesit mësimor përmes pyetësorëve të studentëve, si dhe monitorime në nivel institucional. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore te punës së Departamentit, ku përfshihen vlerësimet e pedagogëve dhe studentëve për lëndët dhe syllabuset (Referenca nr. 30.7 Shpërndarja e relacionit mbi syllabuset). Procedurat e monitorimit të mësimdhënies përshkruhen në Regulloren e UET (Referenca nr. 8. Dokumenti F VII Per sigurimin e brendshem te cilësisë).</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve nga Departamenti dhe KSBC dokumentohen në raportet vjetore dhe u bëhen të njohura autoriteteve vendimarrëse (Referenca 38. Format i relacionit për monitorimin e syllabuseve). Po ashtu, Komisionit të Sigurimit të Brendshem të Cilësisë dhe Zyra e Kurrikulave përgatisin raportimin në nivel institucional për procese të ndryshme monitorimi (Referenca 30.7 Shpërndarja e relacionit mbi syllabuset) dhe ua bëjnë të njohur stafëve drejtuese vendimarrëse për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe</p>	<p>Raportet e vlerësimit të Komisionit të Sigurimit të Brendshem të Cilësisë diskutohen në të gjitha njësitë e UET, me synim adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë në të ardhmen.</p>



përmirësimin në vijim të cilësisë.	Mbështetur në të dhënat e paraqitura në raportet e vlerësimit hartohen planet vjetore të punës së njëjësive bazë, hartohen urdhra e vendime në nivel institucional (Referenca 8. Dokumenti F VII Per sigurimin e brendshem te cilësisë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	GVJ konfirmon se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga KSBC (Referenca 30. Të dhëna mbi individët e angazhuar ne KSBC). Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin që ofron programin e studimit. Baza e analizës për vlerësimin e brendshëm janë të gjithë dokumentet dhe raportimet e hartuara nga njësi bazë dhe njësitë e tjera. Grupet ad-hoc të vetëvlerësimit të brendshëm përbëhen nga anëtarë të njësisë bazë që ofron programin, anëtarë të stafit administrativ dhe përfaqësues nga studentët, sikurse u verifikua nga GVJ gjate takimeve me ta ne institucion. Departamenti evidenton elementët qe lidhen me programin e studimit dhe i ben pjese te vetëvlerësimit né kuadër të akreditimit institucional.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	UET ka një sistem të vlerësimit me metoda dhe instrumente të unifikuara, ndersa vetë njësitë bazë përdorin edhe instrumente specifike që pasurojnë informacionin e mbledhur për vlerësimin e programeve të studimit. Nga biseda me stafin akademik të Departamentit doli e qartë se ata organizojnë takime mujore për të vlerësuar ecurinë në programin e studimit në tërësi, ndonese, monitorimin e procesit te provimeve, silabuset, literaturat e përdorura, nese jane te perditesuara, etj. Instrumentet kryesore që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe pyetësorët, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, perfaqesimi ne KSBC, etj.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për	Për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit, krahas formave të larmishme të përmendura më sipër, përdoren edhe vlerësimi i pedagogëve për njeri tjetrin nëpërmjet formularëve standard që bëhen nga KSBC (Referenca 30. Të dhëna mbi individët e angazhuar ne KSBC), mbledhjeve mujore në department për ecurinë e procesit mësimor, takimeve me stafin akademik të jashtëm, vlerësimi paraprak i tezës së provimit nga drejtuesi i departamentit sipas formatit të standardizuar; dëgjime në auditor të pedagogëve dhe studentëve; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës profesionale. Në kushtet e vijimit të procesit akademik online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams, sipas

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	Vendimit të Senatit Akademik, monitorimi i zhvillimit të leksioneve dhe seminareve është mundësuar nga Zyra e IT e UET (Referenca 5.1- Vendim mbi zhvillimin e procesit akademik në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19). (Referenca Nr. 30.8 - Formulari i vlerësimit të pedagogut nga pergjegjesi i Departamentit dhe kolegët). (Referenca Nr. 40 - Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët)			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Nga biseda me stafet drejtuese të institucionit rezultoi se në nivel institucioni edhe në nivel njësie bazë përdoren edhe metoda të tërthorta për vlerësimin e ecurisë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit si: monitorimi i syllabuseve nëse janë konform formateve të përcaktuara nga VKM dhe Departamenti, rezultatet e studentëve në provime dhe në detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup, rezultatet e praktikës profesionale dhe të punimit të diplomave, si dhe rezultatet e punësimit të studentëve. Në rastin e këtij programi studimi Bachelor ne Sociologji ishte e veshtire per studentet e diplomuar te gjendej punesimi i pershtatshem si Sociolog, profesion qe pak e vlereson tregu dhe Departamenti ishte i shqetesuar se ky fakt po frenonte studentet te ndiqnin kete program studimi i cili ishte me zero studente ne vitin akademik 2021-2022.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. Anëtarët e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë përfaqësues të personelit akademik, përfshirë edhe nje ekspert te jashtem (Referenca 30.4 Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC). Bordet e Tregut të Punës po ashtu, angazhohen për sigurimin e cilësisë. Gjate 2016-2019, UET është përfshire në dy projekte europiane që kanë zhvilluar me tej kapacitetet e UET për sigurimin e cilësisë: projekti TEMPUS “ENCHASE” dhe projekti Erasmus+ QainAL (Referenca 30.9 Fisha e projektit Enchase; dhe Referenca 30.10 Fisha e projektit QainAL). Njohja me qasje të reja evropiane dhe vizitat studimore i kanë sherbyer UET per rishikimin e akteve rregullatore dhe instrumenteve të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Lidhur me sigurimin e cilësisë, edhe projekti Erasmust+ KA 1 mundësoi shkëmbime përvojash të stafit akademik dhe administrativ (Referenca 28.5 Të dhëna mbi projektet dhe mobilitetin e stafit).
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për	Institucioni ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p>njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Anëtarët e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i cili koordinon veprimtarinë e zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, sekretarisë mësimore, Departamentit, Zyrës së Kurrikulave, Alumnit, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në Statutin dhe Rregulloren e UET, si edhe në planet e punës të tyre (Referenca 2 – Statuti i UET, nenet 11, 16 dhe 20). (Referenca 8. Rregullore e programit të studimit).</p>			
<p>.Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë garantohet përfshirja e personelit akademik nga Departamenti, stafit ndihmës administrativ dhe studentëve. Po ashtu, ka respektivisht nga një përfaqësues në GVB, me të cilët GVJ realizoi takimin gjatë vizitës në institucion. Metodologjia dhe procesi i hartimit të RVB tregon përfshirjen e të gjithë aktorëve në këtë proces (Referenca 30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC).</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>UET ka përcaktuar standarde që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset ciklike të vlerësimit të tilla si: kompetencat profesionale; paanshmëria; qasja në informacionet për të kryer vlerësimin; dhe se anëtarët e KSBC të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET (Referenca Nr. 8. Rregullore e programit të studimit).</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Sikurse u përmend edhe më sipër, angazhimi i ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC, konsulencat me Bordin e Tregut të Punës, si dhe projektet e BE të lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, tregojnë se UET ka angazhuar aktorë të si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet diskutimeve në takimet dhe aktivitetet e përbashkëta, etj. (Biseda e GVJ me drejtuesit dhe strukturat e sigurimit të cilësisë në UET).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohen në kohë reale në faqen online të UET: https://uet.edu.al KSBC e zhvillon aktivitetin sipas një Plani Veprimi vjetor i cili bëhet i njohur për gjithë strukturat e UET dhe raportet e detajuara me gjetjet përkatëse për programin e studimit bëhen publike për stafet respective akademike dhe studentët sipas tematikave që lidhen me ta (Biseda e GVJ me drejtuesit e institucionit; Referenca 30).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon</p>	<p>Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në UET ka të</p>



rezultatet e vlerësimeve të programi të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	përcaktuara parime që sigurojnë garantimin e transparencës, informimin e personelit dhe studentëve mbi raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit, duke respektuar Kodin e Etikës dhe Rregulloret e UET.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Përgjegjësi i Departamentit si dhe stafi akademik ishin tepër kërkues për të përmirësuar programin e studimit Bachelor në Sociologji i cili nuk kishte përmbushur pritshmëritë e tyre nisur nga numri i ulët i studentëve të regjistruar. Rezultatet e vlerësimeve të përvitshme ato i konsideronin të dobishme, sikurse edhe sugjerimet e GVJ për ta thjeshtëzuar profilizimin me 5 profile të Programit Bachelor në Sociologji (Biseda e GVJ me drejtuesit e Departamentit dhe stafin akademik).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Programi i studimit Bachelor në Sociologji, që kur është hapur para tre vjetësh, nuk ka pësuar ndryshime sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi, edhe pas vlerësimeve periodike nga Përgjegjësi i Departamentit, Koordinatori i programit, përgjegjësit e grup-lendëve, si dhe strukturat në nivel institucional për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Pas rezultateve jo tërheqëse për studentët, programi i studimit ka nevojë për rishikime strukturore dhe përmbajtësore.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Zyra e Standardeve dhe Cilësisë si dhe KSBC organizon veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin ndërgjegjesimin dhe trajnimin e atyre që janë pjesë e strukturave vleresuese në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Veprimtaritë periodike fillojnë që me njohjen e tyre me kuadrin rregullator të UET në javën e parë informuese për studentët, ashtu edhe me nisjen e kontratës së punës për personelin akademik, si dhe me bërjen publike të raporteve të vlerësimit nga strukturat e sigurimit të cilësisë (Takimi i GVJ në institucion).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
“Sociologji” me profile ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Infrastrukturë moderne për garantimin e mësimdhënies, e përshtatshme me pajisje teknologjike, akses në internet, biblioteka online, etj.
2. Sistem informatik i menaxhimit të informacionit LMS që mundëson qarkullimin e informacionit në kohë reale për studentët dhe stafin akademik e administrativ.
3. Staf akademik me kualifikime jashtë vendit dhe personalitete të njohura publike.
4. Shërbime shumë të mira ndaj studentit që nga momenti i regjistrimit e deri në daljen në tregun e punës.
5. Pjesëmarrje në projektet e BE për garantimin e cilësisë së mësimdhënies, aplikimin e metodave inovative në procesin mësimor, shkëmbimin e eksperiencave duke mundësuar pjesëmarrje në kërkim shkencor e publikime për stafin akademik.
6. Një faqe zyrtare të pasur me informacionet e nevojshme për të gjithë të interesuarit.

Pika të dobta:

1. Fusha e studimit e Sociologjisë nuk përputhet plotësisht me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit ndërkombëtar të programeve të studimit. Sociologjia klasifikohet në 03 Shkencat Sociale, përputhet me emërtimin e Departamentit që e ofron, por jo me emërtimin e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike, fusha të cilat kanë qenë bashkë, por tashmë janë ndarë në dy klasifikime: Shkencat Juridike kanë kaluar në klasifikimin 04. Juridike dhe Biznesi sipas ISCED.
2. Programi Bachelor në Sociologji ka edhe profile që nuk lidhen ngushtë me fushën e studimit të Sociologjisë, sic është profile “Administratë Publike”, duke sjellë disorganizim të programit të studimit.
3. Numër i pakët studentësh, që nuk garanton të ardhura të mjaftueshme për financimin e programit, ndonëse financimi nuk është i ndarë me programe studimi.
4. Studentët nuk janë të përfshirë në kërkimet shkencore të stafit akademik të UET.

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon rishikimin e emërtimit të Fakultetit duke ndarë Shkencat Politike nga ato Juridike dhe vendosja e Departamentit në fushën e Shkencave Sociale ku i takon Sociologjisë.
2. Programi Bachelor në Sociologji ka 5 Profile, “Sociologji Politike”, “Antropologji Sociale”, “Administratë Publike”, “Marrëdhënie Publike” dhe “Gazetari” nga të cilat vetëm dy të parat mund të përfshihen në fushën e sociologjisë. GVJ rekomandon që



- profilet e tjera si “Gazetari” dhe “Administratë Publike” të mos jenë profile të këtij programi studimi.
3. Pasja e 5 Profile që në fazën e parë të hapjes së një programi studimi Bachelor Sociologji kanë mund të krijojë konfuzion tek studentët dhe në një fazë të dytë, mund të kryhej profilizimi. GVJ rekomandon që profilizimi të ndodhë në një moment të dytë.
 4. GVJ rekomandon që të përfshihen studentët të Sociologjisë në sondazhet me pyetesorë që organizon UET me qëllim që ata të kuptojnë vlerat e profesionit të sociologut dhe të rrisin reputacionin e këtij profesioni.
 5. GVJ rekomandon që të përfshihen studentët e këtij programi studimi në projektet e Departamentit dhe të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
 6. GVJ rekomandon që klubi i sociologjisë “Marx” të bëhet me atraktiv, që studentët e Sociologjisë të tërhiqen në aktivitete me interes për ta dhe të njohin avantazhet e profesionit të ardhshëm të Sociologut.
 7. Nevoja për marrëveshje specifike bashkëpunimi në nivel Departamenti për këtë program studimi do të shërbente si një nxitje për studentët e Sociologjisë që t’u hapeshin mundësitë e punësimit.


Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor “Sociology” with profiles offered by the Institution of Higher Education “European University of Tirana”

Strengths and Affirmations:

1. Modern infrastructure to guarantee teaching, suitable with technological equipment, internet access, online library, etc.
2. LMS (information management computer system) enables real-time information circulation for students and academic and administrative staff.
3. Academic staff with qualifications abroad and well-known public personalities.
4. Very good student services from the moment of registration until entering the labor market.
5. Participation in EU projects to guarantee the quality of teaching, the application of innovative methods in the teaching process, the exchange of experiences enabling participation in scientific research and publications for the academic staff.
6. Rich official website with the necessary information for all interested parties.

Weaknesses:

1. The field of study of Sociology does not fully match the academic and research field of the main unit, responsible for the study program, according to the international classification/codification of study programs. Sociology is classified in 03 Social




Sciences, it matches the name of the Department that offers it, but not with the name of the Faculty of Legal and Political Sciences, fields that were together, but have already been divided into two classifications: Legal Sciences have moved to classification 04 Legal and Business according to ISCED.

2. The Bachelor program in Sociology also has profiles that are not closely related to the field of study of Sociology, such as the "Public Administration" profile, bringing disorganization of the study program.
3. Small number of students, which does not guarantee sufficient income for financing the program, although the financing is not divided by study programs.
4. Students are not involved in the scientific research of the academic staff of EUT.

Recommendations:

1. EEG recommends revising the name of the Faculty by separating Political Sciences from Legal Sciences and placing the Department in the field of Social Sciences where it belongs to Sociology.
2. Bachelor Program in Sociology has 5 Profiles, "Political Sociology", "Social Anthropology", "Public Administration", "Public Relations" and "Journalism", of which only the first two can be included in the field of sociology. EEG recommends that other profiles such as "Journalism" and "Public Administration" should not be profiles of this study program.
3. Having 5 Profiles, that in the first phase of opening a Bachelor of Sociology study program, could create confusion among students and it is recommended that in a second cycle, profiling could be done.
4. EEG recommends that Sociology students be included in the questionnaire surveys organized by UET in order for them to understand the values of the sociologist profession and increase the reputation of this profession.
5. EEG recommends that the students of this study program be included in the projects of the Department and the academic staff engaged in this study program.
6. EEG recommends that the "Marx" sociology club be made more attractive, that sociology students be attracted to activities of interest to them and recognize the advantages of the future profession of sociologist.
7. The need for specific cooperation agreements at the Department level for this study program would serve as an incentive for Sociology students to open employment opportunities.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X